



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

### EKSTRAKT

nëga procesverbal i mbajtur më 17 korrik 2014, në mbledhjen e VII-të  
( shtatë) e jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.10'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësish kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësish Afrim Shabani, Bahri Blakçori, z. Islam Revuç Fidan Rekaliu , Haki Rudari, , Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashjtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe financave, z. Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Palnifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, z. dhe z. Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE-së.

**Kryesusesi z. Mehmet Gashi**, arsyetoi thirrjen e kësaj mbledhjeje të jashtëzakonshme, përkatësish që në kërkesë të Ministrisë së Financave, në afat shumë të shkurtë duhet të miratohet Vendimi për rishikimin e buxhetit të Komunës për vitin 2014.

#### 1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua njëzëri.

#### 2. Propozimi i Vendimit për rishikimin e buxhetit për vitin 2014

- z. **Isuf Latifi**, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.
- z. **Kadri Avdiu**, theksoi, fillimisht vërejtja ime konsiston në pikën 1 ku thuhet " Asfaltimi i rrugës lagjja e Kuvajtit...", kur është e ditur se me një vendim të Kuvendit ajo lagje është emërtuar Lagjja e Dëshmorëve, andaj kërkoj që në të ardhmen, për atë lagje, në dokumente zyrtare të mos përdoret emërtimi i vjetër.

Përveç asfaltimit të rrugës së cekur, nën pikën 1 të propozimit të këtij vendimi, është edhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Kërpimeh, Penuhë, Majac dhe Dobratin e që shuma arrin në 203,203 € dhe të gjitha këto mjete barten në projektin asfaltimi i rrugës në Balloc, unë nuk e kuptoj përsë prej gjithë atyre projekteve të hiqen shumat përkatëse e të barten në një projekt të vetëm.

Njësoj edhe nën pikën 2 heqen mjete nga katër projekte në fshatra të ndryshme dhe shuma prej 59,011.36 € bartet për asfaltimin e disa rrugëve në fshatin Llapashticë.

Pas vërvshimeve në vazhdimësi kemi kërkuar me këmbëngulësi që të bëhet ridestinimi i mjeteve për zgjerimin e shtretërve të lumenjeve dhe tanë mjetet e parapara për zgjerimin e lumit prej digës së liqenit të Batllavës, hiqen dhe ridestinohen për diçka tjeter, përmua kjo është e pakuptimtë.

Në pikën 3, parashihet që nga kanalizimi fekal në Peran dhe kolektori i ujërave të zeza në Gllamnik, shuma prej 40,000 € të bartet në projektin kanalizimi fekale në Llapashticë të Poshtme, për këtë konsideroj se nuk është në rregull që nga projekti i kolektorit të ujërave të zeza mjetet të barten në kanalizim.

Më e dhimbshmja dhe më e pakuptimta është se mjetet e propozuara për ridestinim e arrijnë shumën afro 1 milion euro, kjo është papërgjegjësi e institucioneve komunale.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, për ne nuk është problem deshifrimi i kodeve, mirëpo jam i mendimit se për shumicën e këshilltarëve të Kuvendit është e vështirë t'i gjejnë elementet për debat dhe mbështetjen e projekteve të cilat kanë qenë prioritare deri në paraqitjen e këtij dokumenti.

Do të përqendrohem në projektin e kanalizimit në fshatin fshatin Dyz, që ka qenë në prioritetet nga viti 2005, në vlerë prej 28.500 €, mjetet të cilat propozohet që të ridestinohen në vazhdimin e kanalizimit fekal në Dumnicë të Poshtme, ne e kuptojmë nevojën elektorale dhe nevojën e mbështetjes politike të trevave të caktuara që u përkasin subjektit të juaj politik, mirëpo nuk është në rregull që projekti i cekur për dhjetë vite të jetë në prioritetet për një komunitet dhe mjetet përkatëse të ridestinohen gjetiu, unë jam në dijeni se subjekti i juaj politik ka humbur në atë nëndegë. Gjithashtu është anashkaluar edhe rruga Batllavë-Dyz që shpie në drejtim të lagjes Zymeraj, ku me ndihmën e mundësive të subjektit tonë politik jemi munduar të përmirësojmë infrastrukturën që kjo ka shkuar edhe në interes të Komunës ngase me punët e kryera janë eliminuar shpenzimet komunale. Mjetet për shenjëzimin vertikal dhe horizontal në shumë prej 6.500 € janë paraparë të ridestinohen në projektin riparimi dhe ndërtimi i urave, me këtë propozim unë nuk pajtohem ngase duhet të marrim parasysh aksidentet e shumta në komunikacion prej tyre edhe raste tragjike dhe sipas mendimit tim jemi Komuna e fundit në aspektin e shenjëzimeve meqë nuk e kemi së paku një semafor në mënyrë që vijuesit e autoshkollave të mos detyrohen të shkojnë në Prishtinë.

**z. Haki Rudari**, theksoi, në parim mbështes ridestinimin aty ku ka nevojë dhe është interes i qytetarëve, mirëpo jam kundër kur ridestinimi bëhet në baza politike apo partiakë kur mjetet merren nga një vend dhe dërgohen në një vend tjeter.

Për asfaltimin e rrugëve në qytet gjithsej janë paraparë 456.068,00 € por në të njëjtën kohë kemi shumë mungesë të rrugëve të mira në qytet e në veçanti kemi mungesë të rrugëve të asfaltuara në lagje të qytetit, andaj në këtë drejtim duhet pasur kujdes më të madh.

Sa i përket vërshimeve, pak ju ka kushtuar rëndësi, jam i mendimit se kësaj çështjeje duhet dhënë rëndësi me kohë në veçanti në vendet që janë prekur nga vërshimet të investohet më shumë në mënyrë që të evitojen dëmet eventuale.

Për trotuare janë paraparë 75.000,00 €, konsideroj se në këtë aspekt duhet dhënë prioritet shkollave të cilat janë buzë rrugëve të asfaltuara ku ka pas aksidente me pasoja tragjike si pasojë e mungesës së trotuareve.

Komuniteti i fshatit Siboc më ka paraqitur ankesa për shkak të grumbullimit të ujërave të zeza dhe kundërmimit të padurueshëm, andaj për këtë kërkojnë zgjidhje.

Konsideroj se Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Bujqësisë duhet të kenë mjete më të shumta për shkak të rëndësisë së tyre, përkatësisht interesave të nxënësve dhe qytetarëve në përgjithësi.

**z. Fidan Rekaliu**, theksoi, jam i mendimit se ridestinimi i propozuar është në përputhje me ligjin dhe ne Grupi i këshilltarëve të LDK – së e mbështetim ngase këto ridestinime kanë të bëjnë me përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve.

LDK gjatë gjithë qeverisjes në Komunën e Podujevës ka investuar në çdo cep të territorit të Komunës dhe nuk ka bërë ndarje të mjediseve siç u cek gjatë këtij debati.

**z. Naim Çunaku**, theksoi, nga pasqyrat e prezantuara, për mua shqetësuese është ajo që në vazhdimësi është potencuar por edhe kësaj radhe dominon e kjo ka të bëjë me aktivitetet dhe angazhimet përfitimin e një donacioni nga një organizatë ndërkombëtare rreth hartimit të Strategjisë për veprim në mjedis, mirëpo sipas këtij materiali ridestinimet kryesisht grumbullohen në ndërtimin e kanalizimeve. Gjithashtu për gjendjen e lumenjve është folur mjaftë shumë por përkundër kësaj asgjë nuk është ndërmarr në këtë aspekt, e për këtë problematikë e përmendi kolegu nga radhët e LVV- së se sot është bela të jetohet afër lumenjve ngase tre lumenjtë e Komunës sonë në vazhdimësi janë duke u degraduar me mjete të qytetarëve përkatësisht ndërtimin e kanalizimeve të cilat derdhen në lumenj dhe të pretendosh siç tha kolegu i nderuar që përmes projekteve po iu lehtësohet jeta qytetarëve, unë jam i mendimit se me një veprim të tillë një pjese të qytetarëve po i vështirësoshet mjaft jeta, në veçanti atyre që jetojnë bri lumenjve.

Në këtë kontekst, në kohën e hartimit të projektbuxhetit, kam insistuar te drejtori Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, që të paktën të bëhet dezinfektimi dhe derratizimi i hapësirave përkatëse, mirëpo deri tash asgjë nuk është bërë në këtë drejtim.

Përndryshe jemi duke bërë shumë pak në krijimin e një mjedisit të shëndoshë për jetë por përkundrazi me projekte të ndryshme jemi duke bërë degradime të vazhdueshme të mjedisit ku jetojmë.

Gjatë leximit të materialit kam vërejtur se thuhet “projekte të papërfunduara të vitit paraprak”, nuk përmenden cilat janë ato projekte, pastaj “riparimi i urave” nuk thuhet cilat janë ato ura, pra specifikohet prej ku merren mjetet por nuk specifikohet ku shkojnë mjetet përkatëse.

Për kulturën e Llapit nuk bëhet aq sa do duhej, mjetet të cilat kanë qenë për Shtëpinë e Kulturës tash hiqen dhe shkojnë për kanalizim, kjo për mua nuk është e kuptueshme.

Nëse merret shuma e gjithmbarshme e cila propozohet për ridestinim e cila është afro 1 milion, kjo fletë për mos planifikim të mirë të projekteve prioritare.

**z. Isuf Latifi**, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, duke lexuar rregulla përkatëse, sqaroi se propozimi i këtij vendimi është bërë plotësisht në pajtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore.

Pajtohem me z. Kadri Avdiun, lidhur me emërtimin e Lagjes Kuvajtiane, se kjo lagje është emërtuar Lagja e Dëshmorëve, mirëpo në kohën e miratimit të projekteve prioritare ka qenë emërtimi i parë dhe tash nuk mund të ndërrohet emërtimi i projektit përkatës derisa mbetet projekt i njëjtë.

**z. Kadri Avdiu**, theksoi, ridestinimi i mjeteve nga të hyrat vetanake, nën pikën 1, është kolektori i ujërave të zeza në fshatin Gllamnik, në shumë 5.000,00 €, ndërsa nën pikën 2, i njëjti projekt në shumë 35.000,00 € dhe shtoi, jam i interesuar të di përsë mjetet merren nga një kod, jo vetëm nga projekt i cekur por edhe nga projekte tjera nën pikën 1 e 2 dhe barten në të njëjtin kod por për projekte në mqedise të tjera si dhe në hartimin e projekteve, shtrohet pyetja, për hartimin e çfarë projektesh.

Këshilltari i Kuvendit nga radhët e LDK-së z. Fadan Rekaliu, tha, propozimi i ridestinimeve është në rregull dhe qeverisja komunale ka investuar në tërë territorin e Komunës së Podujevës, lidhur me këtë unë me përgjegjësi them se nga qeverisja komunale në fshatin Dyz që nga viti 2008 nuk është investuar asnjë cent dhe edhe dy vitet e ardhshme nuk parashihet kurrfarë investimi.

**z. Durim Salihu**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, sqaroi arsyet për projektet e propozuara nga kompetenca e Drejtorisë përkatëse me theks se mjetet janë marrë nga projektet të cilat nuk e kanë pas projektin zbatues që është kusht për realizimin e çdo projekti.

Pas votimit u konstatua se me 5 vota për, 5 vota kundër, Kuvendit i rekomandoitet për shqyrtim duke u bazuar në votën shtesë të Kryesuesit të Komitetit, në rast të numrit të votave të barabarta.

### **3. Propozimi i Vendimit për dhënien në mirëmbajtje të hapësirës turistike në liqenin e Batllavës**

**z. Durim Salihu**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e paraqiti fjalën hyrëse.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, në nenin 4 të propozim vendimit thuhet "Bazuar se gjatë sezonit veror në liqenin e Batllavës ka fluks të madh të vizitorëve dhe krijohen mbeturina të shumta...." dhe vazhdon "Komuna, në periudhën e realizimit të këtij projekti, pajtohet që të hyrat e arkëtuara nga ofrimi i shërbimeve në hapësirën turistike të janë të hyra të Kompanisë", ne nuk jemi kundër që një kompani e përzgjedhur në mënyrë të rregullt ta mirëmbajë ambientin, mirëpo jemi kundër ngase e gjithë kjo është bërë në mes të Kryetarit të Komunës dhe drejtorit të Kompanisë përkatëse, e që të përmendurit i takojnë të njëjtit subjekt.

Ndërsa në nenin 5 thuhet "Mënyra dhe kushtet e menaxhimit të hapësirës përkatëse më afërsisht do të përcaktohen me kontratë të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe Kompanisë" e kjo do të thotë se si janë marrë vesh ata të dy ashtu do të kryhen punët në terren. Përndryshe formulimi i këtillë krijon edhe dyshime të tjera.

Nga drejtori z. Durim Salihu, i cili në këtë çështje e përfaqëson Kryetarin e Komunës, kërkoj sqarime se përveç largimit të mbeturinave që në këtë aspekt ne të gjithë qytetarët duhet të kemi kujdes, por në mënyrë ligjore është e obliguar Komuna, andaj shtrohet pyetja, me dhënien në mirëmbajtje të hapësirës përkatëse çka përfiton Komuna e Podujevës dhe qytetarët e saj.

Unë kam kontaktuar me shumë qytetarë të fshatit Orllan duke përfshirë edhe persona që i përkasin subjektit të jaja politik (LDK) dhe nga bisedat që i kam pas me ta kam krijuar përshtypjen se të gjithë janë kundër që mirëmbajtja t'i jepet kësaj kompanie, në veçanti janë kundër pagesës që bëhet në hyrje, andaj konsideroj se pa u miratuar ky vendim duhet të merret edhe mendimi i komunitetit se a janë të kënaqur me punën e kësaj kompanie që e ka bërë në sezonin veror të vitiit të kaluar.

Konsideroj se kontrata nuk mund të vazhdohet në mënyrë ligjore, në mënyrë joligjore mund të vazhdohet ashtu siç është dhënë herën e parë, andaj unë jam kundër që Kompanisë së cekur t'i jepet në mirëmbajtje hapësira përkatëse vetëm me vendim të Kuvendit pa u zhvilluar paraprakisht një konkurrencë e drejtë transparente, kjo është mënyra demokratike.

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, theksoi, në rastin konkret qëllimi dhe interesit i Komunës është vetëm ruajtja dhe mirëmbajtja e ambientit, ngase në atë hapësirë gjatë sezonit të verës hidhen me tonë mbeturina, dhe mirëmbajtja është propozuar t'i jepet Kompanisë "Pastrimi" e cila është kompani publike por edhe e licencuar për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse, kjo është e vetmja kompani e licencuar ngase nuk ka kompani private të licencuar për bartjen e mbeturinave.

Gjithashtu duhet pas parasysh se prona kryesisht është e KEK – ut, kompani prej së cilës e kemi marrë pëlqimin për dhënie në mirëmbajtje të asaj hapësire.

Sa i përket pagesës, banorët e asaj treve nuk paguajnë kurrfarë pagesa.

Sa i përket ligjshmërisë të propozimit të këtij vendimi ju informoj se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, vitin e kaluar, e ka vlerësuar të ligjshëm të njëtin vendim.

**z. Naim Çunaku**, theksoi, vitin e kaluar kur e kemi miratuar vendimin për dhënie në mirëmbajtje të hapësirës te liqeni i Batllavës kemi ngritur dilema, para se me na dalë telashe me Ministrinë e Ambientit e cila pretendon se me ndërtimin e plazheve degradohet cilësia e ujit.

Jam në dijeni se një pjesë e paluajtshmërisë nuk është pronë e Komunës, mirëpo disa investime e ndërtime i ka bërë Komuna dhe një aset i Komunës po i jepet në shfrytëzim një Kompanie të jashtme e cila do të vjet të mira materiale dhe shtronet pyetja, çfarë përfitimi do të kenë qytetarët dhe Komuna e Podujevës.

Kryesuesi gjatë diskutimit paraprak sqaroi se Kompania "Pastrimi" është e licencuar, lidhur me këtë ndoshta jam gabim por sa unë jam në dijeni licenca është e nevojshme vetëm për deponitë, aty ku bëhet grumbullimi i mbeturinave, ndërsa për ato që merren me pastrimin nuk kanë nevojë për licencë, siç është rasti në Prishtinë ku disa kompani merren me pastrimin dhe mirëmbajtjen e lokaliteteve të caktuara.

Sipas mendimit tim, duke u bazuar se nuk është paluajtshmëri e Komunës çështja nuk është e sqaruar, mirëpo sikur të ishte pasuri e Komunës në asnjë mënyrë nuk do të pajtohesha nëse nuk do të jepej në mirëmbajtje pa konkurrencë.

**z. Haki Rudari**, theksoi, në nenin 2 të propozimit të vendimit thuhet, "Kompania bënë mirëmbajtjen e infrastrukturës në të gjitha plazhet" formulimi i këtillë atë hapësirë e shndërron në vend turistik, me këtë biem në kundërshtim me ligjin që rregullat përmbrojtjen e ambientit, andaj nuk do ta mbështes këtë vendim.

Ankesat qytetarëve janë edhe për atë se në hyrje të liqenit kërkohet pagesa edhe për njerëz që shkojnë te familjarët e tyre, te kompleksi "Zahir Pajaziti" dhe gjetiu. Jam i mendimit se një vend që shfrytëzohet përmjet përdorimit të shndërrrohet në plazhe nuk është në rregull dhe vota ime do të jetë kundër.

**z. Isuf Latifi**, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, mua askush nuk mund të më bind se miratimi i propozimit të këtij vendimi nuk është në interes të qytetarëve të Komunë së Podujevës, por edhe më gjerë, shtrohet pyetja çfarë do të ndodhë nëse nuk pastrohen mbeturinat në veçanti gjatë sezonit të verës kur frekuentimi i pushuesve në liqe është shumë i madh që krijohen me tonë mbeturina dhe nëse këto nuk pastrohen qo të bëhet degradim total i ambientit por me këtë do të rezikohet edhe ndotja e liqenit nga i cili furnizohen qytetarët e disa komunave duke përfshirë edhe qytetarët e Prishtinës.

U përmend ndërhyrja e Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, unë kam biseduar me përfaqësuesit e asaj Ministrie dhe të jeni të bindur se edhe ata pajtohen plotësisht që në ratë se kjo gjendje neglizohet pasojat do të jenë të shumëfishata.

**z. Naim Çunaku**, theksoi, i dëgjuam arsyetimet e parafolësit mirëpo shtrohet pyetja çfarë e kemi gjendjen me lumenjtë tanë që sipas dispozitave ligjore jemi ligjërisht të obliguar t'i mbrojmë, ndërsa tani të them na ka ra hise si institucione të Komunës të mbrojmë një pasuri që nuk është e Komunës së Podujevës që investojmë atje ndërsa për atë që jemi të obliguar me ligj, por edhe jemi kompetent me ruajt ambientin po i myllim sytë, pra ajo pasuri nuk është e jona dhe çfarëdo që të ndodhë nuk bartim përgjegjësi ngase nuk është e jona.

**z. Kadri Avdiu**, theksoi, drejtori z. Isuf Latifi i dha disa sqarime por unë diçka nuk e kam të qartë dhe atë nëse na ka mbetur në gjendje të keqe vetëm liqeni i Batllavës dhe të tjerat e të tjerat i kemi në rregull atëherë ky do të ishte problem i vogël, por çfarë të thuhet kur familjet që jetojnë në atë trevë edhe gjatë sezonit veror edhe gjatë sezonit dimëror përballen me mbeturina të shumta dhe Komuna e jonë nuk ka ndërmarrë asgjë, lidhur me këtë para 4-5 muajve kam kërkuar nga drejtori i Drejtorisë kompetente të ndërmerrën veprimet e nevojshme përmirësuar që zgjidhjen e kësaj çështjeje dhe më është thënë se kjo çështje do të zgjidhet në prill mirëpo tash jemi në korrik dhe asgjë nuk është ndërmarrë në këtë drejtim.

Si mund të mbështetet propozimi i këtij vendimi kur thuhet se në hyrje të liqenit duhet të paguhen 2 €, shtrohet pyetja a duhet të paguajnë edhe personat të cilët shkojnë te të afërmit e tyre por edhe ata përmjet qëllime të tjera e as që e kanë në mendje liqenin.

**z. Afrim Shabani**, theksoi, duke u bazuar se është një projekt që është financuar edhe prej Komisionit Evropian, me një shumë mjaftë të madhe, dhe qëllimi është mirëmbajtja e ambientit në një pjesë të territorit të Komunës tonë, gjithashtu edhe ujin e përdorimit të liqenit i Batllavës që do të ishte e dëmshme përmirësuar qytetarët e Komunës tonë por edhe përmjet qëllime të tjera e as që e kanë në mendje liqenin.

sipërfaqen e madhe të atij ambienti dhe shpenzimet për mirëmbajtjen e tij, jam i mendimit se pagesat e propozuara nuk janë të larta.

**z. Haki Rudari**, theksoi, nga përvaja personale ju them se vitin e kaluar kemi pas problem ngase nuk lejohej të kaloj autobusi me nxënës, andaj derisa nuk evitohet në tërësi një mundësi e tillë, vota ime nuk do të jetë në mbështetje të këtij vendimi.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, askush nuk është kundër mirëmbajtjes së ambientit në hapësirën për të cilën po debatojmë, mirëpo shtrohet pyetja se a është propozuar forma më e mirë për mirëmbajtjen e atij ambienti, pra nuk është propozuar asnjë alternativë tjeter e një prej tyre është punësimi i pesë punëtorëve sezonal, pra unë jam për çdo formë tjeter përveç kësaj që është propozuar.

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, theksoi, jam i bindur se nuk do të shkelet ligji nëse miratohet propozimi i këtij vendimi, gjithashtu jam i mendimit se mirëmbajtja e hapësirës përkatëse mund t'i jepet vetëm kompanive të licencuara.

Shtrohet pyetja nëse brenda një muaji nuk pastrohet ajo hapësirë, pajtoheni me mua se sigurisht do të bëhen mbeturina me tonë.

Pas votimit u konstatua se me 5 vota për, 5 vota kundër dhe asnjë të përbajtur, Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim, duke u bazuar në votën shtesë të Kryesuesit të Komitetit, në rast të numrit të votave të barabarta.

#### **4. Propozimi i Vendimit për kompensimin e punëve dhe angazhimeve të Komisionit për propozimin e emërtimeve të zonave, lagjeve urbane, shesheve, parqeve, rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës**

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, e paraqiti fjalën hyrëse.

**z. Naim Çunaku**, theksoi, unë nuk kam mbajtur evidencë për takimet e këtij Komisioni, mirëpo disa anëtarë kanë mbajtur evidencë dhe sipas tyre janë mbajtur mbi 30 takime por duke u bazuar se ne anëtarët e Komisionit kemi biseduar për çështjen e kompensimit dhe në atë rast janë bërë propozime konkrete, por sa më përket mua as atëherë e as tash nuk pajtohem me shumën që është propozuar për kompensim.

Propozimi im është që ose të mos bëhet fare kompensimi ose të ngritët shuma e propozuar.

**z. Kadri Avdiu**, theksoi, propozimi i këtij vendimi ka ardhur nga Ekzekutivi, por Komisionin e ka ngritur Kuvendi dhe konsideroj se Ekzekutivi nuk ka pas nevojë të propozoj kurrfarë shume ngase jemi në dijeni që Komiteti për Politikë dhe Financa mund të vendos deri në shumën 10.000 € dhe nga kjo ky vendim nuk ka pas nevojë fare të shqyrtohet në Kuvend.

Sa i përket shumës së kompensimit, ne kemi biseduar dhe kemi thënë se do të konsultohemi edhe me komuna të tjera por do të bazohemi edhe në shtrirjen hapësinore ngase nuk është njësoj sikur 16 apo 25 fshatra krahasuar me mbi 80 fshatra.

Jeni në dijeni se kur e kemi shqyrtuar këtë çështje në Komision propozimi ka qenë 1.000 €, unë kam qenë ai që kam propozuar shumën minimale 700 €, shumë e cila së paku do t'i mbulonte shpenzimet e bëra për, siç u përmend, mbi 30 takime të mbajtura duke mos i përmend edhe takimet të cilat duhet t'i

mbajmë, andaj ose duhet të ngritët shuma e kompensimit ose ne tërhiqemi dhe nuk do ta mbështesim propozimin e këtij vendimi.

**z. Durim Salihu**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, theksoi, nuk më intereson çështja e kompensimit të anëtarëve të Komisionit por konsideroj se ne duhet t'i përvishemi punës dhe ta kryejmë obligimin që e kemi marrë përsipër ngase deri tash, përveç takimeve publike, nuk kemi bërë asgjë tjetër.

**z. Kadri Avdiu**, theksoi, unë në mënyrë të qartë thash se ose të ngritët shuma ose ne tërhiqemi, nuk do të lëshohemi në lojën që është bërë propozimi për shumën prej 500 €, ngase kjo çështje është bërë shumë e madhe.

**z. Naim Çunaku**, theksoi, ajo që më shqetëson më së tepërmë është se ne po arrijmë t'i bëjmë disa marrëveshje mirëpo asnjëra prej atyre marrëveshjeve nuk shkon deri në fund, të them rrugës deformohen dhe e humbin kuptimin.

Në diskutimin paraprak unë nuk fola në cilësinë e anëtarit të këtij Komiteti por në cilësinë e anëtarit të Komisionit për propozimin e emërtimeve të rrugëve, që në këtë Komision jemi tre anëtarë nga radhët e KPF – së, por tani do të flas në cilësinë e anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa, për informim në një takim e kemi diskutuar këtë çështje dhe kemi arritur një marrëveshje që për mbledhjen e kaluar të KPF – së të paraqiten dy propozime, propozimi i parë ka qenë shqyrtimi i mundësive për ofrimin e ndihmës financiare për shefin e Grupit të këshilltarëve të LDK- së, mirëpo propozimi i dytë që ka qenë çështja për të cilën tani jemi duke debatuar nuk ka ekzistuar vullneti për shqyrtim dhe vendosje.

Pra deformimi i marrëveshjes na ka irrituar pa masë meqë nëse ne e luajmë lojën kush kënd po e mund kjo nuk është forma përmes së cilës mund të ecim përpara e me këtë konsideroj se është duke u rrezikuar një proces por fundja përgjegjësia është e shumicës.

Nëse pajtohemi të bëhem solidar unë i pari do të punoj dy muaj apo më tepër mirëpo kushtëzimet nuk mund t'i pranoj.

Pas votimit u konstatua se me 5 vota për, 5 vota kundër dhe asnë të përmbajtur, Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim, duke u bazuar në votën shtesë të Kryesuesit të Komitetit, në rast të numrit të votave të barabarta.

Mbledhja përfundoi në orën 15.10 '

**Procesverbalin e mbajti**  
**Faik Gashi**

**Nr. 01- 006-79799**  
**Podujevë,**  
**17 korrik 2014**

**Kryesuesi i Komitetit**  
**Mehmet Gashi**